



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 193, dt.22.07.2016

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, bazuar dhe në nenin 11 të rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit”, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 22.07.2016, pasi shqyrtoi kërkesën për ndryshim të drejtuesit teknik restaurator të shoqërisë “JOGI CO sh.p.k” ark. *Gentian Stratobërdha* me ing. *Pellajia Basha*,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “JOGI CO sh.p.k” për ndryshim të drejtuesit teknik restaurator ark. *Gentian Stratobërdha* me drejtuesen teknike restauratore ing. *Pellajia Basha*.
2. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, miratimin e kërkesës për pajisje me licencë restaurimi për shoqërinë “JOGI CO” sh.p.k, me drejtues ligjor z.Josif Basha, në kategorinë: CZ: “Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi”, me drejtues teknik restaurator ing. *Pellajia Basha*. (R.P.69).
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI